

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KOMUNËN KSAMIL, SARANDË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Ksamil, Sarandë**, me objekt: “*Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 132, datë 24.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 592/6, datë 24.9.2014, i ka rekomanduar z. Besnik Abedini Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Komuna Ksamil të analizojë me të gjithë stafin, Raportin Përfundimtar të Auditimit në të cilin janë paraqitur shkeljet e konstatuara, ndërkohë të përgatisë një program pune të veçantë me persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të dërguara bashkëlidhur këtij raporti.

Menjëherë

2. Komuna Ksamil të marrë masa për zbatimin e planit të buxhetit sipas strukturës buxhetore në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “*Për Menaxhimin e Sistemit Financiar në Republikën e Shqipërisë*”,

Në vijimësi

3. Gjetje: Është konstatuar se nuk është hapur regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre nuk është mbajtur në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” dhe Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” kreu III “*Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre*” pika 30 ku përcaktohen dhe ... “*Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve, në vartësi të llojit*”

3.1. Rekomandim: Komuna Ksamil të marrë masa për hapjen e regjistrit të aktiveve dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre, të regjistrojë dhe përditësojë të dhënat për ndryshime në zbatim të kërkesave ligjore në fuqi.

Brenda datës 31.11.2014

4. Gjetje: Gjatë auditimit rezulton se nuk është mbajtur libri i madh apo centralizatori, ku të jenë kaluar veprimet, si çelja në fillim të vitit, debi kreditë sipas llogarive sintentike të realizuara gjatë vitit ushtrimor kjo bazuar në ditarët analitik si ditari i bankës, arkës, magazinës dhe i veprimeve të ndryshme dhe gjendja në fund të vitit. Bilancet kontabël janë nxjerrë mbi bazën e të dhënave mbi të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në situacionin vjetor të rekorduara me degën e thesarit. Mbajtja e kontabilitetit dhe kalimi i veprimeve nga ditarët analitik në librin e madh apo në centralizor, janë kërkesa të parashkuara në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin*”, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006 dhe udhëzimi MF nr.14, datë 28.12.2006 ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që*

varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”.

4.1. Rekomandim: Komuna Ksamil të marrë masa për mbajtjen e kontabilitetit të çelë librin e madh, centralizatorin si dhe të bëhet sistemimi i veprimeve të rezultuara nga auditimi me pozicione jo të rregullta të pa analizuara si dhe të kryhen veprimet në kontabilitet e të bëhet sistemimi në balance.

Brenda datës 31.12.2014

5. Gjetje: Është konstatuar se nuk është bërë plotësimi i dokumentacionit dhe pasqyrimi në dokumentet e organizimit të tenderit, llogaritja e fondit limit dhe e kostos për vlerat limit për të gjitha prokurimet me vlerë të vogël të parashikuar në buxhetet vjetore për blerje mallrash, kryerje shërbimesh apo ndërtime në zbatim VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me blerje të vogla” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 16.07.2013 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 28.02.2014, si dhe Udhëzimin nr. 4, datë 04.07.2013 “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimeve elektronike për autoritetin kontraktor dhe operatorët ekonomik” ndryshuar me Udhëtimin nr. 3, datë 03.04.2014 .

5.1. Rekomandim: Komuna Ksamil të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit dhe pasqyrimin në dokumentet e organizimit të tenderit, llogaritja e fondit limit dhe e kostos për vlerat limit për të gjitha prokurimet me vlerë të vogël të parashikuar në buxhetet vjetore për blerje mallrash, kryerje shërbimesh apo ndërtime.

Në vijimësi

6. Gjetje: Është konstatuar se nuk janë zbatuar procedurat e aplikimit për regjistrimin në ZVRPP Sarandë të pasurive dhe Pronave të transferuara me VKM nr. 476 datë 29.06.2011, në zbatim të kreut IV neni 18 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, ”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” -Neni 18- Dokumentacioni i transferimit, dhe me pikat 1, 2 të nenit 45 të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, për rrjedhojë nuk janë pasqyruar në kontabilitet në përputhje me: Kreun II Neni pikat 1-2 Kreu III neni 12, neni 18 pika 1 të ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe : Pjesën (I), pikat 2, 5, 6, 7, 8, 9 a- b-c, pikat 10, 12, 13. Pjesa (III) pikat 26, 28. Pjesa (IV) pikat 73, 74,75 Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

6.1. Rekomadim: Komuna Ksamil të marrë masat dhe të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin në ZVRPP Sarandë e pasurive dhe Pronave te transferuara me VKM nr. 476 datë 29.06.2011 dhe pasi të ketë përfunduar regjistrimin e pasurive në ZVRPP Sarandë, të nisë inventarizimin fizik dhe përfshirjen e vlerës në pasqyrën përkatëse të evidencës kontabël për zërat “toka, troje, terrene”, objekte të ndryshme duke i pasqyruar në bilancin e vitit 2014.

Brenda datës 30.12.2014

7. Gjetje: Është konstatuar lidhja e dy kontratave qiraje të kundraligjeshme me afat 8 vjeçar nga viti 2013 deri 2021 për znj. D.P. me sipërfaqe 500 m² dhe z. Dh.C. me sipërfaqe 530 m² , mbasi këto sipërfaqe nuk janë të regjistruara si pronë e komunës, në kundërshtim me VKM nr. 529 datë 08.06.2011 i ndryshuar dhe me VKM nr. 54 datë 05.02.2014, për rrjedhojë të kryhen procedurat e pezullimit në zbatim të neneve nr. 115, 116 pika “c” dhe 117 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Për Kodin e Procedurës Administrative”.

7.1. Rekomandim: Komuna Ksamil të marrë masa për pezullimin e procedurave administrative, për dy kontratat e lidhura me afat 8 vjeçar nga viti 2013 deri 2021 për znj. D.P. me sipërfaqe 500 m² dhe z. Dh.C. me sipërfaqe 530 m².

Menjëherë

8. Gjetje: Është konstatuar se rezultojnë mbi vendosje me fondin e tokës Bujqësore brenda territorit të Komunës Ksamil, ndërsa për zgjidhjen e konflikteve të pronësisë nuk është bashkëpunuar nga komuna Ksamil me ZVRPP Sarandë për t’i zgjedhur nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë

8.1. Rekomandim: Komuna Ksamil të marrë masa, në bashkëpunim me ZVRPP Sarandë dhe ti kërkojë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për zgjidhjen e konflikteve të pronësisë me mbi vendosje me fondin e tokës Bujqësore brenda territorit të Komunës Ksamil.

Brenda datës 31.12.2014

9. Gjetje: Nuk është kryer inventarizimi, marrja në dorzim nga drejtoria e shërbimit pyjor dhe regjistrimi në ZVRPP Sarandë i 307 ha kullota dhe 207 ha pyje (shkurre), të përfituara në zbatim të VKM nr. 476 datë 29.06.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Ksamil të Qarkut të Vlorës”.

9.1. Komuna Ksamil të marrë masa, për inventarizimin, marrjen në dorëzim nga drejtoria e shërbimit pyjor dhe regjistrimin në ZVRPP Sarandë të sipërfaqeve prej 307 ha kullota dhe 207 ha pyje (shkurre).

Brenda datës 31.12.2014

10. Gjetje: Nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aseteve në lidhje me inventarizimin e materialeve të komunës dhe të arsimit, si dhe komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit kjo për arsye se nga komisioni i inventarizimit në inventarët e kryer kanë rezultuar materiale jashtë përdorimit si për aparatën e komunës dhe administratën e arsimit, kjo në zbatim të kërkesave të ligjit Nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 kreu IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” “Inventarizimi i aktiveve” pikat 73 dhe 74 si dhe “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi”.

10.1. Rekomandim: Komuna Ksamil të marrë masa, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të inventarizimit të materialeve dhe komisionit për nxjerrjen jashtë përdorimit të materiale të rezultuara si për aparatën e komunës dhe arsimin.

Brenda datës 31.12.2014

11. Gjetje: Janë konstatuar mangësi në sistemimin dhe kompletimin e dokumentacionit të zbatimit të kontratave nga zyra e financës dhe prokurimeve publike duke i mos i pasqyruar edhe elektronikisht këto të dhëna dhe të pa dorëzuara me inventar në arshivën e komunës, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

11.1. Rekomandim: Komuna Ksamil të marrë masa për të sistemuar dhe kompletuar dokumentacionin e zbatimit të kontratave nga zyra e financës dhe prokurimeve publike duke i pasqyruar edhe elektronikisht këto të dhëna dhe më pas dorëzimin me inventar në arshivën e komunës.

Menjëherë

12. Gjetje: Nuk janë zbatuar nga ana e Titullarit të autoritetit kontraktor masat për formatimin e përbërjes e KVO-së dhe Njësisë së Prokurimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Kreu 5, pika 1, germa b dhe pika 2, germa ç dhe Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet Publike”, i ndryshuar.

12.1. Rekomandim: Titullari i autoritetit kontraktor të marrë masa për formatimin e përbërjes e KVO-së dhe Njësisë së Prokurimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në zbatim të akteve ligjore.

Menjëherë

13. Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar se për investimet e kryera duhen marrë masat e mëposhtme:

a- Për llogari të subjektit “K...” shpk, shuma prej 492,564 lekë, është shumë e dubluar për të njëjtin periudhë duke dubluar fondi limit dy herë padrejtësisht për 23 ditë. **b-** Nuk ka raport teknik dhe situacione të miratuara nga Supervizori dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor, kryesisht për faturat e Tvsh nr. 41, datë 12.03.2014 dhe nr. 45, datë 08.04.2014 të lëshuara nga firma “K...” shpk për shërbimet e kryera, në bazë të kontratës shtesë, për muajin Shkurt dhe Mars 2014.

c- Autoriteti kontraktor në bazë të nenit 8, pika 3 të kontratës duhet t’i kërkojë sipërmarrësit “K...” shpk të zbatojë me korrektësi të gjitha pikat e kontratës, në të kundërt të aplikohen

penalitet e përcaktuara në kontratë, gjithashtu duhet t'i kërkohe realizmi i zërit dezinfektim në përputhje me nenin 20, pika 3 të kontratës.

d- Për urdhër shpenzimet dhe faturat e likuidimet të karburantit, del se nuk janë shoqëruar me dokumentet justifikuese, si raporti i analizave para zhdoganimit të lëshuar nga Inspektorati Qendror Teknik për sasinë e produktit gazoil, buletini i APP-së sipas datave përkatëse, referuar çmimet bursës Reuters, “*Deklarata doganore SAD*”, kërkesa me shkrim e palëve, në përputhje me VKM nr. 1, dt. 10.01.2007, “*Për rregullat e prokurimit publik*” Kreu VIII, pika 2/c dhe kontratës së datës 14.03.2013, neni 16, paragrafi i fundit.

13.1. Rekomandim: Komuna Ksamil për investimet e kryera të marrë masat e mëposhtme:

a- Vlefta **492,564 lekë** të mos kryhet likuidimi për llogari të subjektit “K...” shpk, pasi është dubluar fondi limit dy herë padrejtësisht për 23 ditë për të njëjtin periudhë.

b- Të mos likuidohen faturat e Tvsh nr. 41, datë 12.03.2014 dhe nr. 45, datë 08.04.2014 të lëshuara nga firma “K...” shpk për shërbimet e kryera, në bazë të kontratës shtesë, për muajin Shkurt dhe Mars 2014, pasi nuk janë shoqëruar me raport teknik të supervizorit si dhe situacionet nuk janë miratuar nga Supervizori dhe Titullari i Autoritetit Kontraktor.

c- Autoriteti kontraktor në bazë të nenit 8, pika 3 të kontratës duhet t'i kërkojë sipërmarrësit “K...” shpk të zbatojë me korrektësi të gjitha pikat e kontratës, në të kundërt të aplikohen penalitet e përcaktuara në kontratë, gjithashtu duhet t'i kërkohe realizmi i zërit dezinfektim në përputhje me nenin 20, pika 3 të kontratës.

d- Komuna Ksamil të marrë masa që urdhër shpenzimet dhe faturat për likuidimet e karburantit, duhet të shoqërohen me dokumentet justifikuese, si raporti i analizave para zhdoganimit të lëshuar nga Inspektorati Qendror Teknik për sasinë e produktit gazoil, buletini i APP-së sipas datave përkatëse, referuar çmimet bursës Reuters, “*Deklarata doganore SAD*”.

Në vijimësi

14. Gjetje: Nuk kanë dalë njoftim vlerësimet për 91 subjektet të cilat nuk kanë paguar detyrimet për vlerën **4,189,150 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”, (sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit)

a- Nuk janë dërguar pranë Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b- Nuk janë dërguar Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit (për pasurinë e paluajtshme), kjo bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”.

c- Për subjektet që nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nuk janë zbatuar procedurat tatimore për arkëtimin e detyrimeve, duke llogaritur dhe masa administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008) të depozitohet kallëzim penal në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pikës 130-132 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kodit Penal i RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

14.1. Rekomandim: Për vlerën **4,189,150 lekë**, që i përket 91 subjektet të cilat nuk kanë paguar detyrimet (sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit), pasi të dalin njoftim vlerësimet, nga zyra e Taksave të Komunës Ksamil, të veprohet;

a- Të dërgohen pranë Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka;

b- Ti dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e barrës siguroese (për mjetet) dhe Zyrës së Regjistrimit (për pasurinë e paluajtshme);

c- Për subjektet që nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të zbatohen procedurat tatimore për arkëtimin e detyrimeve, duke llogaritur dhe masa administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit.

Brenda datës 31.12.2014

15. Gjetje: Është konstatuar se nuk janë kryer arkëtimet e detyrimeve të pa likuiduara të debitorëve deri më datën 31.12.2013 për taksën e banesës për popullatën që paraqitet në vlerën

863,940 lekë dhe për tarifën e pastrimit për popullatën në vlerën **118,950 lekë**.

15.1. Rekomandim: Zyra e Taksave e Komunës Ksamil, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara të debitorëve deri më datën 31.12.2013 për taksën e banesës për popullatën në vlerën **863,940 lekë** dhe për tarifën e pastrimit për popullatën në vlerën **118,950 lekë**.

Brenda datës 31.12.2014

16. Gjetje: Është konstatuar se nuk janë kryer arkëtimet e detyrimeve në shumën **3,356,438 lekë** që u përket 42 subjekteve, që ushtrojnë aktivitet të pa licencuar, në të kundërt të aplikohet masa administrative gjobë në masën 25,000 lekë, sipas nenit 112 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore", dhe të zbatohen procedurat tatimore për mbylljen e veprimtarisë në rast mos arkëtimi nga ana e tyre në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" dhe ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" neni 41. (Lista me personat debitorë të cilët nuk janë regjistruar në QKR, deri më datën 31.12.2013, paraqitet në aneksin nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

16.1. Rekomandim: Komuna Ksamil, të marrë masat për arkëtimin e detyrimit në shumën **3,356,438 lekë** që u përket 42 subjekteve, që ushtrojnë aktivitet të pa licencuar, në të kundërt të aplikohet masa administrative gjobë në masën 25,000 lekë, sipas akteve ligjore. (lista sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

Brenda datës 31.12.2014

17. Gjetje: Është konstatuar se nuk janë kryer inventarizimin e dosjeve të 248 subjekteve, që ushtrojnë aktivitet në Komunën Ksamil, duke i përditësuar dhe plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm si: Njoftim detyrimi; Dokumenti i Pagesës së detyrimit; Gen-Planet apo planimetritë (kjo për taksën e ndërtesave); Akt-konstatimet apo Akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit, të konfirmuara dhe nga Policia e Komunës. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në RSH", neni 29, -Dosja e detyrimeve tatimore, pika 1.

17.1. Rekomandim: Zyra e Tatim Taksave të komunës të kryejë inventarizimin e dosjeve të 248 subjekteve, që ushtrojnë aktivitet në Komunën Ksamil, duke i përditësuar dhe plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm si: Njoftim detyrimi; Dokumenti i Pagesës së detyrimit; Gen-Planet apo planimetritë (kjo për taksën e ndërtesave); Akt-konstatimet apo Akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit, të konfirmuara dhe nga Policia e Komunës.

Brenda datës 31.12.2014

18. Gjetje: Nga zyra e Tatim Taksave të komunës nuk janë dërguar zyrtarisht zyrës së Financës, listat e debitorëve për detyrimet fiskale, me qëllim kontabilizimin e detyrimit, llogaritjen e kamat vonesave dhe ndjekjen ligjore të ekzekutimit të tyre.

18.1. Rekomandim: Zyra e Tatim Taksave të komunës të dërgojë zyrtarisht zyrës së Financës, listën e debitorëve për detyrimet fiskale, me qëllim kontabilizimin e detyrimit, llogaritjen e kamat vonesave dhe ndjekjen ligjore të ekzekutimit të tyre.

Në vijimësi

19. Gjetje: Është konstatuar se në zyrën e taksave, subjektet nuk plotësojnë dhe depozitojnë deklaratën e qarkullimit, në zbatim të nenit 113 për mbajtjen e librave të xhiros dhe për mos deklarimin në afat të gjobiten subjektet në masën 10,000 lekë, në zbatim të nenit 117 të ligjit, nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore", i ndryshuar.

19.1. Rekomandim: Zyra e Tatim Taksave vendore të kërkojë që, subjektet të plotësojnë dhe depozitojnë në zyrën e taksave, deklarata e qarkullimit, në zbatim të nenit 113 për mbajtjen e librave të xhiros dhe për mos deklarimin në afat të gjobiten subjektet në masën 10,000 lekë.

Menjëherë dhe Në vijimësi

20. Gjetje: Është konstatuar se nga zyra e Taksave vendore dhe policia e komunës nuk është hartuar paketa me llojet dhe masën e gjobës, si dhe t'i propozohet Këshillit të Komunës, të vendosë për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, siç përcaktohet në shkronjën (a) të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", neni 6 "Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative".

20.1. Rekoamndim: Zyra e Taksave vendore dhe policia e komunës të hartojnë paketën me llojet dhe masën e gjobës, dhe t'i propozohet Këshillit të Komunës, të vendosë për çdo shkelje të

cilat përbëjnë kundërvajtje administrative.

Brenda datës 31.12.2014

21. Gjetje: Është konstatuar se zyra e Taksave të komunës Ksamil, për subjektet të cilat nuk zbatojnë afatet e përcaktuara, nuk ka aplikuar dënim me gjobë nga 5% në muaj, por jo më shumë se 25% të detyrimit për taksën për pagesën e vonuar të kësteve të detyrimeve, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

21.1. Rekomandim: Zyra e Taksave të Komunës Ksamil, për subjektet të cilat nuk zbatojnë afatet e përcaktuara, të aplikojë dënim me gjobë nga 5% në muaj, por jo më shumë se 25% të detyrimit për taksën për pagesën e vonuar të kësteve të detyrimeve.

Në vijimësi

22. Gjetje: Gjatë periudhës së audituar rezultoi se janë dhënë leje zhvillimi (në raste të pakta) pa u miratuar Instrumenti i Përgjithshëm Vendor i Planifikimit të Territorit nga KKT (Këshilli Kombëtar i Territorit për Komunën Ksamil në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 "Për planifikimi e territorit".

22.1. Rekomandim: Të mos jepen leje zhvillimi pa u miratuar Instrumenti i Përgjithshëm Vendor i Planifikimit të Territorit nga KKT (Këshilli Kombëtar i Territorit për Komunën Ksamil.

Menjëherë

23. Gjetje: Është konstatuar se në territorin e juridiksionit të komunës Ksamil janë kryer ndërtime pa leje ndërtimi, për të cilat janë mbajtur procesverbalet e konstatimit nga INUV i komunës Ksamil bazuar në ligjin nr.9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", në nenin 15 "Kundërvajtjet administrative të Kryeinspektre, inspektre dhe gjobat", ndërsa për periudhën në vazhdim të ndjekë në vazhdimësi kontrollin e territorit me synim mos lejimin e ndërtimeve pa leje në territorin e kësaj komune.

23.1. Rekomandim: INUV i Komunës Ksamil të ndjekë në vazhdimësi kontrollin e territorit me synim mos lejimin e ndërtimeve pa leje në territorin e kësaj komune.

Në vijimësi

24. Gjetje: Nga komuna Ksamil zyra e personelit duhet të marrë masa, për rihvillimin e procedurave të përzgjedhjes së punonjësve të policisë, duke zbatuar plotësisht kriteret e urdhrin të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 "Për miratimin e rregullores "TIP" të policisë bashkiake dhe të Komunës", pikat 4 dhe 5.

24.1. Rekomandim: Komuna Ksamil të marrë masa, për rihvillimin e procedurave të përzgjedhjes së punonjësve të policisë, në zbatim të kërkesave të akteve ligjore.

Brenda datës 31.10.2014

25. Gjetje: Është konstatuar se nuk janë kryer arkëtimet e detyrimeve në vlerën **265,000 lekë** nga Policia e komunës për arkëtimin e 25 gjobave të nendosura dhe të pa paguara deri më datën 30.06.2014, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 14 pika 2 dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", përkatësisht nenet 9, 22 dhe 30.

25.1. Rekomandim: Policia e komunës të marrë masa, për arkëtimin e 25 gjobave të pa paguara deri më datën 30.06.2014 për vlerën **265,000 lekë**.

Brenda datës 31.11.2014

26. Gjetje: Gjatë auditimit kanë dalë mangësi në dosjet e personelit me dokumentacionin ligjor jo të plotë, për rrjedhojë ka mos përputhje të pozicionit të punës me nivelin arsimor dhe konkretisht dokumentacioni që i përket dosjes së znj. E.K..

26.1. Rekomandim: Komuna Ksamil të marrë masa, për rekrutimin e punonjësve të kualifikuar dhe me arsimim përkatës për secilin pozicion pune, të plotësohen mangësitë në dosjet e personelit me dokumentacionin ligjor si dhe të ulë menjëherë në detyrë znj. E.K., duke e vendosur në një pozicion të barazvlefshëm me arsimimin përkatës, gjithashtu të mos emërojnë persona pa arsimin përkatës në pozicione pune në administratë.

Menjëherë

27. Gjetje: Janë konstatuar mangësi në plotësimin e dosjeve me dokumentacionin përkatës për shpërndarjen e ndihmës ekonomike në zbatim të kërkesave të VKM nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave dhe masës së ndihmës ekonomike dhe udhëzimit nr.338/3, datë 10.03.2006.

27.1. Rekomandim: Komuna Ksamil të marrë masa për plotësimin e dosjeve me dokumentacionin përkatës për dhënien e ndihmës ekonomike.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative në të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbarimor, me qëllim arkëtimin e vlerës **71,189,260 lekë,** nga kjo:

a. 53,833,603 lekë dëm ekonomik,

b. 17,305,657 lekë mungesë të ardhurash, dhe konkretisht:

1. Gjetje: Nga zyra e financës është likuiduar tepër firmës fituese “I...” shpk, vlera **19,585 lekë,** për karburantin pasi nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar në buletinin e APP-së.

1.1. Rekomandim: Të kryhet arkëtimi i vlerës **19,585 lekë** nga firma fituese “I...” shpk, likuiduar tepër për karburantin, pasi nuk është respektuar çmimi i miratuar sipas kontratës për furniturën bazuar në buletinin e APP-së.

Brenda datës 31.12.2014

2. Gjetje: Është likuiduar vlera **74,224 lekë** subjektit OE “J...Company” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Riveshje rruga nga shkolla fillore – kinoteatër”, për punime të pakryera.

2.1. Rekomandim: Të arkëtohet vlera **74,224 lekë** nga subjekti OE “J...Company” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Riveshje rruga nga shkolla fillore – kinoteatër”, për punime të pakryera.

Brenda datës 31.12.2014

3. Gjetje: Është likuiduar vlera **226,650 lekë** bashkimit të subjekteve OE “I...” sh.p.k dhe “J...Company” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim rruga Kinoteatër – përballë ishujve (rruga 17/1)”, për punime të pakryera.

3.1. Rekomandim: Të arkëtohet vlera **226,650 lekë** nga subjektet: OE “I...” sh.p.k dhe “J...Company” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim rruga Kinoteatër – përballë ishujve (rruga 17/1)”, për punime të pakryera.

Brenda datës 31.12.2014

4. Gjetje: Është likuiduar vlera **116,566 lekë** subjektit OE “O...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës Hasan Tahsini”, për punime të pakryera.

4.1. Rekomandim: Të arkëtohet vlera prej **116,566 lekë** nga subjekti OE “O...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugës Hasan Tahsini”, për punime të pakryera.

Brenda datës 31.12.2014

5. Gjetje: Është konstatuar dëm ekonomik me vlerë prej **1,135,836 lekë** që përfaqëson mos llogaritja e saktë në zbatim të vendimeve të këshillit të komunës nr. 26, datë 16.01.2012 dhe nr. 48, datë 08.10.2012, për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime të reja. (sipas aneksit nr. 3 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Të kërkohet në rrugë administrative dhe ligjore detyrimi prej **1,135,836 lekë** që përfaqëson nga mos llogaritja e saktë në zbatim të vendimeve të këshillit të komunës nr. 26, datë 16.01.2012 dhe nr. 48, datë 08.10.2012, llogaritja e pagesës së taksës së ndikimit në

infrastrukturë për ndërtimet e reja. (sipas aneksit nr. 3 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Brenda datës 31.12.2014

6. Gjetje: Nga auditimi ka rezultuar mos arkëtimi i vlerës prej 22,649,811 lekë që përfaqëson: vendosjen e **42 gjoba** në vlerën **14,568,632 lekë** dhe mos zbatimimi i sanksioneve ligjore për mos llogaritjen e kamatës në masën 2% për 30 ditë të shumës së detyrimit të pa arkëtuara brenda afatit ligjor të caktuar është krijuar një dëm ekonomik për buxhetin e komunës Ksamil **për 8,081,179 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, neni 15 “Kundërvajtjet administrative (Sipas aneksit nr. 4 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandim: Të kërkohet në rrugë administrative dhe ligjore detyrimi prej 22,649,811 lekë që përfaqëson: vendosjen e **42 gjoba** në vlerën **14,568,632 lekë** dhe mos zbatimimi i sanksioneve ligjore për mos llogaritjen e kamatës në masën 2% për 30 ditë të shumës së detyrimit të pa arkëtuara brenda afatit ligjor të caktuar është krijuar një dëm ekonomik për buxhetin e komunës Ksamil **për 8,081,179 lekë**.

Brenda datës 31.12.2014

7. Gjetje: Është konstatuar dëm ekonomik me vlerë prej **207,926 lekë**, përsa përfituar padrejtësisht si më poshtë:

Për vlerën 207,926 lekë, për pagesa të kryera më tepër për z. M.L. paguar orë jashtë kohës normale të punës në vlerë **80,986 lekë** dhe znj. E.K. pa arsim të lartë, në vlerën **126,940 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve grupimin e qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore i ndryshuar me VKM nr.586, datë 17.7.2013 bashkëlidhur lidhja nr.2.

7.1. Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën **207,926 lekë**, përsa përfituar padrejtësisht si më poshtë:

- z. M.L. paguar orë jashtë kohës normale të punës në vlerë **80,986 lekë** dhe
- znj. E.K. pa arsim të lartë, në vlerën **126,940 lekë**.

Brenda datës 31.12.2014

8. Gjetje: Është konstatuar dëm ekonomik me vlerë prej **51,837,816 lekë**, nga kjo:

a) Për vlerën 630,770 lekë, për pagesa të kryera më tepër në 9 raste vitin 2012 e 2013, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Financiar në Republikën e Shqipërisë”, neni 67 dhe 68, si dhe kritereve të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011.

(Sipas aneksit nr. 5 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit)

b) Për vlerën 32,246 lekë, për pagesë të kryer për z. B.A. për shpenzime telefon celularë në kundërshtim me VKM Nr. 864 datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik” lidhja nr. 1-6 bashkëlidhur vendimit.

c) Për vlerën 49,912,800 lekë, për pagesa të pa kryera për rrënjë ulliri, në kundërshtim me VKM nr. 473 datë 14.10.1999, miratuar tarifa për rrënjë të ullirit, që kanë moshën mbi 30 vjet në vlerë 750 lekë, ose më pakë 700 lekë për rrënjë (155 ha pemëtore dhe 250 ha ullishte, zona kadastrale 2297 dorëzuar në AKKP dhe Komunës Ksamil në përdorim). (Sipas aneksit nr. 6 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandim: Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit në vlerën **51,837,816 lekë**, nga kjo:

a) Për vlerën 630,770 lekë, për pagesa të kryera më tepër në 9 raste vitin 2012 e 2013. (Sipas aneksit nr. 5 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit)

b) Për vlerën 32,246 lekë, për pagesë të kryer për z. B.A. për shpenzime telefon celulare.

c) Për vlerën 49,912,800 lekë, për pagesa të pa kryera për rrënjë ulliri.

(Sipas aneksit nr. 6 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Brenda datës 31.12.2014

9. Gjetje: Është konstatuar dëm ekonomik me vlerë prej **1.262,000 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 529 datë 08.06.2011 i ndryshuar me VKM nr. 54 datë 05.02.2014, mbasi janë lidhur kontrata me afat 8 vjeçar dhe është llogaritur më pak detyrimi për qira me dëm ekonomik për buxhetin e Komunës Ksamil nga znj. **D.P.** në vlerë **725,000 lekë dhe z. Dh.C.** në vlerë **537,000 lekë**.

9.1. Rekomandim: Të arkëtohet vlera prej **1.262,000 lekë**, që i përket mos llogaritjes më pak të detyrimit për qira me dëm ekonomik për buxhetin e Komunës Ksamil për znj. **D.P.** në vlerë **725,000 lekë dhe z. Dh.C.** në vlerë **537,000 lekë**.

Brenda datës 31.03.2015

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 144 ,153 dhe 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, si dhe në kontratën individuale të punës, **kërkojmë** që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000“*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, **kryetari i Komunës Ksamil të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore**, si më poshtë:

“Vërejtje me paralajmërim” për:

1. z.B.Sh. me detyrë administrator i ndihmës ekonomike, në cilësinë e anëtarit të KVO-së, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve të vogla për shkeljet e mëposhtme:

- Ka vepruar në kundërshtim me *ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”, në kushtet e mungesës kritereve për kualifikim dhe mangësive në dokumentacion, në pesë raste, përkatësisht në procedurën e anuluar të tenderit “Rikonstruksion i Rrugës Hasan Tahsini” faza e dytë, i datës 26.11.2012, si dhe në procedurën normale të po këtij tenderi të datës 04.12.2012, në tenderin “Rikonstruksion i Rrugës Hasan Tahsini”, shtesë kontrate, “Rikonstruksion rruge nga shkolla fillore deri te kthesa e kinoteatrit”, “Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2013”, “Blerje karburanti të tipit d/1, viti 2013”, “Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2014”,*

- Ka vepruar në kundërshtim me *ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 1 “Parimet e Përzgjedhjes”, pika a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, në 3 raste përkatësisht sipas tenderave “Rikonstruksion i Rrugës Hasan Tahsini” faza e dytë, “Rikonstruksion rruge nga shkolla fillore deri te kthesa e kinoteatrit”, “Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2013”.*

- Ka vepruar në kundërshtim me *VKM Nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ndryshuar, Kreu 7, pika 1 “Mungesa e konkurrencës”, germa a), në tenderin “Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2013”, duke vazhduar procedurën edhe pse mungonin dy oferta të vlefshme.*

-Për mos inventarizim dhe arshivimin e dosjeve të tenderave të vitit 2012, 2013 dhe 2014, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “*Për Arkivat*”.

- Për të meta dhe mangësi për “Prokurimin Publik” Blerje me vlera të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2011 i ndryshuar kreu i I,II dhe i III- të dhe VKM nr. 1 datë 10.01.2007 i ndryshuar, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik kreu II - të pika 1 germa b.c, kreu V pika 2 germa a.ç, kreu i VIII - të pika 2 germa b.

2. z. F.M. me detyrë Përgjegjës i Zyrës Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e mëposhtme dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit për blerjet me vlera të vogla, në komunën Ksamil:

- për të meta dhe mangësi, për mos menaxhimin dhe përdorimin e paligjshëm e sipërfaqeve pa marrëdhënie përdorimi në kundërshtim me VKM nr. 538, datë 7.8.2012 për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Ksamil, VKM nr. 476, datë 29.06.2011 Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Ksamil, në kundërshtim me ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 Për tokat bujqësore të pa ndara, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike të ndryshuar , piken 2 e 3 të VKM nr. 531, datë 21.08.1998 Për tokat bujqësore të pa ndara dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 Për sistemin e taksave vendore, për të meta dhe mangësi në zbatimin e procedurave ligjore, Për Prokurimin Publik Blerje me vlera të vogla në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2011 i ndryshuar kreu i I,II dhe i III - të dhe VKM nr. 1 datë 10.01.2007 i ndryshuar, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik kreu II të pika 1 germa b.c, kreu V pika 2 germa a.ç, kreu i VIII pika 2 germa b,

- Ka vepruar në kundërshtim me *ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve" dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu VII, "Kushte të përgjithshme për zbatim", pika 1, "Mungesa e konkurrencës", germa "a", në kushtet e mungesës kritereve për kualifikim dhe mangësive në dokumentacion, në pesë raste, përkatësisht në procedurën e anuluar të tenderit "Rikonstrukcion i Rrugës Hasan Tahsini" faza e dytë, i datës 26.11.2012, si dhe në procedurën normale të po këtij tenderi të datës 04.12.2012, në tenderin "Rikonstrukcion i Rrugës Hasan Tahsini", shtesë kontrate, "Rikonstrukcion rruge nga shkolla fillore deri te kthesa e kinoteatrit", "Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2013", "Blerje karburanti të tipit d/1, viti 2013", "Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2014".*

- Ka vepruar në kundërshtim me *ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Neni 1 "Parimet e Përzgjedhjes", pika a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, në pesë raste, përkatësisht sipas tenderave "Rikonstrukcion i Rrugës Hasan Tahsini" faza e dytë, "Rikonstrukcion rruge nga shkolla fillore deri te kthesa e kinoteatrit", "Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2014".*

- Ka vepruar në kundërshtim me *VKM Nr.1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ndryshuar, Kreu 7, pika 1 "Mungesa e konkurrencës", germa a), në tenderin "Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2013", duke vazhduar procedurën edhe pse mungonin dy oferta të vlefshme.*

- Për shkelje të konstatuara nga dhënia e lejeve të ndërtimit nga mos llogaritja e saktë në zbatim të vendimeve të këshillit të komunës nr. 26, datë 16.01.2012 dhe nr. 48, datë 08.10.2012, llogaritja e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, duke i shkaktuar një dëm buxhetit të komunës prej **1,135,836** lekë si dhe nga mos dhënia e këtyre leje zhvillimi pa u miratuar Instrumenti i Përgjithshëm Vendor i Planifikimit të Territorit nga KKT (Këshilli Kombëtar i Territorit për Komunën Ksamil në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 "Për planifikimi e territorit".

3. znj. E.K. me detyrë ish-Përgjegjës i Shërbimeve, në cilësinë e supervizorit, për shkeljet e mëposhtme :

- Nuk ka kryer kontrole ditore të shërbimeve që do të realizohen, nuk ka mbajtur procesverbale dhe situacione ditore për masën e kryer të shërbimit duke shkelur detyrat e përcaktuara në nenin 8 të kontratës së datës 04.02.2013 e lidhur ndërmjet Komunës Ksamil dhe sipërmarrësit "Korsel".

- Për hartimin e preventivit jo në përputhje me VKM Nr.175, datë 19.01.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe panit kombëtarë të menaxhimit të

mbetjeve urbane” si dhe ligjin 10463, dt 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, në tenderin për “Grumbullimi, transporti, përpunimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane, viti 2014”.

4. z. A.B. me detyrë Kryeinspektor INUV-së, në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e mëposhtme :

- Ka vepruar në kundërshtim me *ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 1, “Mungesa e konkurrencës”, germa “a”, në kushtet e mungesës kritereve për kualifikim dhe mangësi në dokumentacion, në pesë raste, përkatësisht në procedurën e anuluar të tenderit “Rikonstrukcion i Rrugës Hasan Tahsini” faza e dytë, i datës 26.11.2012, si dhe në procedurën normale të po këtij tenderi të datës 04.12.2012, në tenderin “Rikonstrukcion i Rrugës Hasan Tahsini”, shtesë kontrate, “Rikonstrukcion rruge nga shkolla fillore deri te kthesa e kinoteatrit”, “Blerje karburanti të tipit d/1, viti 2013”, “Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2014”.*

- Ka vepruar në kundërshtim me *ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 1 “Parimet e Përzgjedhjes”, pika a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, në 3 raste, përkatësisht sipas tenderave “Rikonstrukcion i Rrugës Hasan Tahsini” faza e dytë, “Rikonstrukcion rruge nga shkolla fillore deri te kthesa e kinoteatrit”, “Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2014”.*

- Ka vepruar në kundërshtim me *VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ndryshuar, Kreu 7, pika 1 “Mungesa e konkurrencës”, germa a), në tenderin “Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2013”, duke vazhduar procedurën edhe pse mungonin dy oferta të vlefshme.*

- Ndjekja në vazhdimësi për mos lejimin ndërtimeve të reja pa leje në territorin e komunës Ksamil.

- nuk janë llogaritur kamat vonesat prej 2 % për çdo ditë vonese në arkëtim deri në një muaj, me një dëm ekonomik për buxhetin e komunës Ksamil **për 6,201,179 lekë.**dhe së bashku me gjobat 17,969,811 lekë.

“Vërejtje me shkrim” për :

1. z. G.D. me detyrë përgjegjës i zyrës së financës dhe në cilësinë e kryetarit të komisionit komuna Ksamil, për të meta dhe mangësi, për pagesa të kryera më tepër nga banka, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve qarkulluese, në kalimin dhe regjistrimin e aseteve në kontabilitet dhe regjistër, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, dalë në zbatim tijë, për mos zbatimin e planit të buxhetit sipas strukturës buxhetore, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Financiar në Republikën e Shqipërisë”, neni 67 dhe 68, për mos regjistrimin e veprimeve dhe kalimin e tyre në librin e madh apo në centralizator, në kundërshtim me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël si dhe udhëzimit nr. 26 datë 27.12.2007 dalë në zbatim të ligjit. Për të meta dhe mangësi Për Prokurimin Publik” Blerje me vlera të vogla në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2011 i ndryshuar kreu i I,II dhe i III- të dhe VKM nr. 1 datë 10.01.2007 i ndryshuar Për miratimin e rregullave të prokurimit publik kreu II të pika 1 germa b.c, kreu V pika 2 germa a.ç, kreu i VIII pika 2 germa b,

2. z. A.Ç. me detyrë Përgjegjës i zyrës së tatim-taksave, në cilësinë e anëtarit të Njësisë Prokurimit, për shkeljet e mëposhtme :

-Për mos arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara të debitorëve deri më datën 31.12.2013 për taksën e banesës për popullatën që paraqitet në vlerën në vlerën **863,940 lekë** dhe për tarifën e pastrimit për popullatën që paraqitet në vlerën **118,950 lekë**

-Edhe pse janë evidentuar 91 subjekte të cilët janë debitorë deri më datën 31.12.2013 në vlerën **4,189,150 lekë** dhe nga të cilët 18 subjekte nuk kanë paguar taksat për 2 vite 2012-2013 në vlerën **1,417,716 lekë**, ndaj tyre nga punonjësit e taksave nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme **ligjore si më poshtë:**

- nuk janë nxjerrë njoftim vlerësimet, bazuar në nenin 70 pika 3 “ E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”.

-nuk janë marrë masa dhe nuk u janë dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”.

-nuk është kërkuar kallëzim penal, në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, pikës 130-132 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09, 2008 ”Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar ligjit dhe Kodit Penal i RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve.*

-ndaj subjekteve të cilët nuk kanë paguar detyrimet në afat, nuk u janë vendosur masa administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit), sipas nenet 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar.

- Nuk ka respektuar afatet e përcaktuara për dorëzimin e dokumenteve të tenderit, duke u cenuar konkurrenca, në kundërshtim me Nenin 43, pika 7 të “*Ligjit Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, në tenderin Grumbullimi, transporti, përpunimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane, viti 2014,

- Ka vepruar në kundërshtim me *VKM-në Nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, Kreu II, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”,* germa a), c) dhe ç), pasi është llogaritur gabim vlera e kontratës duke u dubluar fondi limit dy herë padrejtësisht për 23 ditë në shumën 492,564 lekë, në tenderin “Grumbullimi, transporti, përpunimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane, viti 2014”.

- Përcaktimet e bëra në lidhje me kapacitetet teknike për makineritë që janë regjistruar në regjistrat publikë nuk janë të plota, në kundërshtim me *VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” ndryshuar, Kreu 5, pika 2, germa a),* në tenderin “Grumbullimi, transporti, përpunimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane, viti 2014”.

- për të meta dhe mangësi, për qiranë e llogaritur për sipërfaqen e dhënë, në kundërshtim me VKM nr. 529 datë 08.06.2011 i ndryshuar, me VKM nr. 54 datë 05.02.2014 dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, Për sistemin e taksave vendore.

3. z. M.K., me detyrë Përgjegjës i Zyrës Administrimit Tokës, në cilësinë e **anëtarit** të Njësisë Prokurimit dhe supervizorit të punimeve, për shkeljet e mëposhtme :

- Nuk ka respektuar afatet e përcaktuara për dorëzimin e dokumenteve të tenderit, duke u cenuar konkurrenca, në kundërshtim me Nenin 43, pika 7 të “*Ligjit Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, në tenderin “Grumbullimi, transporti, përpunimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane, viti 2014”,

- Ka vepruar në kundërshtim me *VKM-në nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, Kreu II, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”,* germa a), c) dhe ç), pasi është llogaritur gabim vlera e kontratës duke u dubluar fondi limit dy herë padrejtësisht për 23 ditë në shumën 492,564 lekë, në tenderin “Grumbullimi, transporti, përpunimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane, viti 2014”.

-Për përcaktimet e bëra në lidhje me kapacitetet teknike për makineritë që janë regjistruar në regjistrat publikë nuk janë të plota, në kundërshtim me *VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” ndryshuar, Kreu 5, pika 2, germa a),* në tenderin “Grumbullimi, transporti, përpunimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane, viti 2014”.

- Nuk ka zbatuar detyrat e përcaktuara në nenin 14 të kontratës Nr 410 Prot, datë 26.03.2014 të lidhur ndërmjet Komunës Ksamil dhe sipërmarrësit “Korsel” shpk.
- për mos mbajtjen, evidentimin administrimin e bilancimit të fondit kullor në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007 Për fondin kullor neni 5,7 dhe 8, për të meta dhe mangësi, për mos menaxhimin dhe përdorimin e paligjshëm e sipërfaqeve pa marrëdhënie përdorimi në kundërshtim me ligjin nr. 8312 datë 26.03.1998 Për tokat bujqësore të pa ndara, ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike të ndryshuar, piken 2 e 3 të VKM nr. 531 datë 21.08.1998, Për tokat bujqësore të pa ndara.

4. z. *M.L.* me detyrë punonjësi i Policisë së Komunës

-Nga ana e punonjësit të Policisë së Komunës, gjatë veprimtarisë së tij nuk janë zbatuar kërkesat e urdhrat të përbashkët të Ministrisë të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003” dhe Ministrisë të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”.

-Ndërmjet policisë së komunës dhe zyrës së taksave së Komunës Ksamil nuk ka këmbim informacioni zyrtar nëpërmjet zyrës së protokollit, por bashkëpunim verbal dhe nga punonjësit e policisë komunës nuk njihet gjendja dhe nuk dihej numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitet në komunën Ksamil.

-Për periudhën 2 vjeçare 2012-2013 dhe 6 mujorin 2014 nga ana e Policisë së Komunës Ksamil, janë vendosur 25 gjopa në vlerën 265,000 lekë nga të cilat 13 janë vendosur nga vetë punonjësi i policisë komunës M.L. dhe 12 gjopat e tjera janë vendime të Këshillit të Komunës. Deri më datën 30.06.2014 nuk është arkëtuar asnjë gjobë dhe nuk janë marrë masa për nisjen e procedurave ligjore për ekzekutimin arkëtimin e tyre të përcaktuara në:

-ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 14 pika 2 ku përcaktohet se: Gjopat paguhen në favor të komunës brenda 15 ditëve nga data kur organi përkatës ka nxjerrë vlerësimin.

-ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 ”Për kundërvajtjet administrative” përkatësisht nenet, 9, 22 dhe 30.

5. z. *D.M.* me detyrë Inspektor INUV (Ish-përgjegjës i Zyrës së Taksave)

-Për mos arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara të debitorëve deri më datën 31.12.2013 për taksën e banesës për popullatën që paraqitet në vlerën në vlerën **863,940 lekë** dhe për tarifën e pastrimit për popullatën që paraqitet në vlerën **118,950 lekë**

-Edhe pse janë evidentuar 91 subjekte të cilët janë debitorë deri më datën 31.12.2013 në vlerën **4,189,150 lekë** dhe nga të cilët 18 subjekte nuk kanë paguar taksat për 2 vite 2012-2013 në vlerën **1,417,716 lekë**, ndaj tyre nga punonjësit e taksave nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme **ligjore si më poshtë:**

- nuk janë nxjerrë njoftim vlerësimet, bazuar në nenin 70 pika 3 “ E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH.

-nuk janë marrë masa dhe nuk u janë dërguar Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

-nuk është kërkuar kallëzim penal, në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, pikës 130-132 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09, 2008 ”Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar ligjit dhe Kodit Penal i RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve.*

-ndaj subjekteve të cilët nuk kanë paguar detyrimet në afat, nuk u janë vendosur masa administrative (gjobë në masën 25% të detyrimit), sipas nenet 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore” , i ndryshuar.

- nuk janë llogaritur kamat vonesat prej 2 % për çdo ditë vonese në arkëtim deri në një muaj, me një dëm ekonomik për buxhetin e komunës Ksamil për 5,921,179 lekë..dhe së bashku me gjobat 16,889,811 lekë.

6. z. **M.E.** me detyrë Inspektor INUV

- nuk janë llogaritur kamat vonesat prej 2 % për çdo ditë vonese në arkëtim deri në një muaj, me një dëm ekonomik për buxhetin e komunës Ksamil për 5,921,179 lekë..dhe së bashku me gjobat 16,889,811 lekë.

Ti kërkohet Kryetarit të Komunës Ksamil në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontrator në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, të vlerësojë sipas shkallës së përgjegjësisë dhe të marrë masa administrative dhe disiplinore për këto persona:

1. **znj. V.V.** me detyrë sekretare në cilësinë e **anëtarit** të Njësisë Prokurimit, për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk ka respektuar afatet e përcaktuara për dorëzimin e dokumenteve të tenderit, duke u cenuar konkurrenca, në kundërshtim me Nenin 43, pika 7 të “Ligjit Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në katër raste, përkatësisht “Rikonstruksion i Rrugës Hasan Tahsini” faza e dytë, “Rikonstruksion rruga nga shkolla fillore deri te kthesa e kinoteatrit 2013”, Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2013, “Blerje karburanti të tipit d/1, viti 2013”.

-Ka shkelur VKM-nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar, Kreu VII, pikal “Mungesa e Konkurrencës”, germa b)Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet, që shkaktuan dështimin e procedurës, dhe i korrigjon ato në mënyrë, që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës”, duke u anuluar procedurën e tenderit 3 herë radhazi, në tenderin “Rikonstruksion i Rrugës Hasan Tahsini” faza e dytë.

-Ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” ndryshuar, Kreu 5, pika 2/a, 2/b dhe Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 42 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit”, pika 2 dhe 2/1, pasi kriteret kualifikuese të publikuara elektronikisht janë të ndryshme nga ato të përcaktuara në procesverbal, në tenderin “Rikonstruksion i Rrugës Hasan Tahsini” faza e dytë.

- Ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” ndryshuar, Kreu IV, pika 5 germa c), ku thuhet “Urdhri për prokurim,....., Me përjashtim të rrethanave të parashikuara në pikat 2, shkronja “b”, 3, shkronja “b”, e 5, të nenit 33, të LPP-së, autoriteti kontraktor fton jo më pak se 3 (tre) kandidatë, duke garantuar konkurrencë dhe barazi ndërmjet tyre.”, pasi nuk janë njoftuar minimalisht 3 kandidatë.

2. z. **E.V.** me detyrë inspektorë tatim-taksave, në cilësinë e **anëtarit** të Njësisë Prokurimit, për shkeljet e mëposhtme :

- Nuk ka respektuar afatet e përcaktuara për dorëzimin e dokumenteve të tenderit, duke u cenuar konkurrenca, në kundërshtim me Nenin 43, pika 7 të “Ligjit Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në pesë raste, në tenderin “Rikonstruksion i Rrugës Hasan Tahsini” faza e dytë, “Rikonstruksion rruga nga shkolla fillore deri te kthesa e kinoteatrit 2013”, Grumbullim, transport, përpunim, depozitim të mbetjeve urbane, viti 2013, “Blerje karburanti të tipit d/1, viti 2013”, Grumbullimi, transporti, përpunimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane, viti 2014,

-Ka shkelur VKM-nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar, Kreu VII, pikal “Mungesa e Konkurrencës”, germa b)Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet, që shkaktuan dështimin e procedurës, dhe i korrigjon ato në mënyrë, që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës”, duke u anuluar procedurën e tenderit 3 herë radhazi, në tenderin “Rikonstruksion i Rrugës Hasan Tahsini” faza e dytë.

- Ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” ndryshuar, Kreu 5, pika 2/a, 2/b dhe *Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar*, Neni 42 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit”, pika 2 dhe 2/1, pasi kriteret kualifikuese të publikuara elektronikisht janë të ndryshme nga ato të përcaktuara në procesverbal, në tenderin “Rikonstrukcion i Rrugës Hasan Tahsini” faza e dytë.

- Ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” ndryshuar, Kreu IV, pika 5 germa c), ku thuhet “*Urdhri për prokurim,....., Me përjashtim të rrethanave të parashikuara në pikat 2, shkronja “b”, 3, shkronja “b”, e 5, të nenit 33, të LPP-së, autoriteti kontraktor fton jo më pak se 3 (tre) kandidatë, duke garantuar konkurrencë dhe barazi ndërmjet tyre.*”, pasi nuk janë njoftuar minimalisht 3 kandidatë.

-Përcaktimet e bëra në lidhje me kapacitetet teknike për makineritë që janë regjistruar në regjistrat publikë nuk janë të plota, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” ndryshuar, Kreu 5, pika 2, germa a), në tenderin “Grumbullimi, transporti, përpunimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane, viti 2014”.

- Ka vepruar në kundërshtim me VKM-në nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, Kreu II, pika 2 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, germa a), c) dhe ç), pasi është llogaritur gabim vlera e kontratës duke u dubluar fondi limit dy herë padrejtësisht për 23 ditë në shumën 492,564 lekë, në tenderin “Grumbullimi, transporti, përpunimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane, viti 2014”.

3. znj E.M. me detyrë ish juriste, në cilësinë e anëtarit të Njësisë Prokurimit,

4. z E.C. me detyrë ish-topograf, në cilësinë e anëtarit të Njësisë Prokurimit

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.

Shënim:

-Për 4 ish punonjësit e larguar nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte:

- “**Zgjidhja e kontratës së punës**” përkatësisht.

1. **K.K.** me detyrë ish-Kryeinspektor INUV-së

- “**Vërejtje me paralajmërim**” përkatësisht.

1. z. **A.Z.** me detyrë ish- përgjegjës i zyrës së shërbimeve dhe në cilësinë e supervizorit,

2. znj. **V.O.** me detyrë ish- sekretare Komune.

3. z. **A.K.** me detyrë ish- zv/kryetar komune.

Për drejtuesit e mësipërm të njoftohet Departamenti i Administratës Publike për masat disiplinore me qëllim kryerjen e regjistrimeve të nevojshme në Regjistrin Qendror të Personelit.

Nga Komuna Ksamil, Sarandë me shkresë nr. 1581, datë 02.12.2014, bprotokolluar në KLSH me nr. 592/7, datë 09.12.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **ku rezulton se rekomandimet janë pranuar pjesërisht dhe zbatuar.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit te detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Qemal Meta, Din Zenelaj, Mirland Cela, Besmir Paja, Rezart Golemaj dhe Jonild Hoxhaj më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT